

Në mbështetje të nenit 14 paragrafi 11 të ligjit “Për armët” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 7/2005) Ministri i Punëve të Brendshme miratoi

**RREGULLOREN PËR PROGRAMIN E TRAJNIMIT MBI PËRDORIMIN,  
MAGAZINIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E DUHUR TË ARMËVE, PËR KRYERJEN E  
TRAJNIMEVE PRAKTIKE NË LIDHJE ME PËRDORIMIN E ARMËVE, SI DHE PËR  
KRYERJEN E TESTIMIT TË NJOHURIVE TEKNIKE MBI PËRDORIMIN E DUHUR TË  
ARMËVE DHE TË NJOHURIVE MBI RREGULLORET E ARMËVE, PËR MARRJEN E  
AUTORIZIMIT**

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Kjo Rregullore rregullon programin e trajnimit mbi përdorimin, magazinimin dhe mirëmbajtjen e duhur të armëve, kryerjen e trajnimeve praktike në lidhje me përdorimin e armëve, si edhe kryerjen e testimit të njohurive teknike mbi përdorimin e duhur të armëve dhe të njohurive mbi rregulloret e armëve, për marrjen e autorizimit.

**II. PROGRAMI I TRAJNIMIT PËR PËRDORIMIN, MAGAZINIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E  
DUHUR TË ARMËVE**

Neni 2

Trajnimi për përdorimin, magazinimin dhe mirëmbajtjen e duhur të armëve kryhet në përputhje me programin e trajnimit për përdorimin, magazinimin dhe mirëmbajtjen e duhur të armëve (në vijim referuar si: “Programi”) (Dokumenti 1).

Neni 3

Programi përbëhet nga pjesa teorike dhe ajo praktike që përfshijnë:

**A. Pjesa teorike**

I. Ligji “Për armët” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 7/2005) dhe aktet nënligjore në zbatim të ligjit “Për armët”;

II. Kodi Penal (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 37/96, 80/99, 4/02, 43/03 dhe 19/04);

III. Ndihma e shpejtë; dhe

IV. Njohuritë teorike mbi përdorimin e sigurt të armëve dhe municioneve (çmontimi, montimi, pastrimi dhe mirëmbajtja e armëve dhe municioneve).

**B. Pjesa praktike**

I. Njohuritë praktike mbi përdorimin e sigurt të armëve dhe municioneve (çmontimi, montimi, pastrimi dhe mirëmbajtja e armëve dhe municioneve). Qitje.

**III. KRYERJA E TRAJNIMIT PRAKTIK PËR PËRDORIMIN E ARMËVE**

Neni 4

Trajnimi praktik për përdorimin e armëve ofrohet nga një person juridik i autorizuar, nga shoqata e gjuetarëve ose e qitësve (në vijim referuar si: personi juridik i autorizuar).

Trajnimi praktik i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni zhvillohet përmes ofrimit të seancave teorike dhe praktike të trajnimit.

Trajnimi teorik dhe praktik i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni kryhet duke organizuar pesë seanca trajnimi për çdo pjesë të programit.

Seanca e trajnimit e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni zgjat 45 minuta.

#### Neni 5

Trajnimi teorik ofrohet nga persona fizikë (në vijim referuar si: trajnuesit) të cilët janë punonjës me kohë të plotë të personit juridik të autorizuar që ofron trajnimin praktik për përdorimin e armëve.

Trajnimi teorik për përdorimin e sigurt të armëve dhe municioneve (çmontimi, montimi, pastrimi dhe mirëmbajtja e armëve dhe municioneve) dhe trajnimi praktik ofrohen nga persona fizikë (në vijim referuar si: instruktorët), si dhe nga persona të tjerë fizikë (në vijim referuar si: ndihmësinstruktorët) të cilët janë punonjës me kohë të plotë të personit juridik të autorizuar që ofron trajnimin praktik për përdorimin e armëve.

Nëse personi juridik i autorizuar që ofron trajnimin praktik për përdorimin e armëve nuk ka punonjës të cilët përmbushin kërkesat sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, trajnimi teorik dhe praktik ofrohet nga persona fizikë të kontraktuar rregullisht për ofrimin e trajnimeve në subjektin juridik.

#### Neni 6

Trajnuesi i përmendur në nenin 5 paragrafi 1 të kësaj Rregulloreje, në përputhje me ligjin, duhet të jetë i diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë (për ofrimin e trajnimeve në lidhje me ligjin “Për Armët” dhe Kodin Penal) ose në Fakultetin e Mjekësisë (për ofrimin e trajnimeve mbi ndihmën e shpejtë).

#### Neni 7

Instruktori i përmendur në paragrafin 2 të nenit 5 të kësaj Rregulloreje, në përputhje me ligjin, duhet të jetë i diplomuar në Fakultetin e Edukimit Fizik, Departamenti i Trajnuesve të Qitjes Sportive. Ndhmës instruktori i përmendur në nenin 5 paragrafi 2 të kësaj Rregulloreje, në përputhje me ligjin, duhet, së paku, të ketë përfunduar arsimin e mesëm.

#### Neni 8

Gjatë ofrimit të trajnimit praktik dhe atij teorik për përdorimin e sigurt të armëve dhe municioneve (çmontimi, montimi, pastrimi dhe mirëmbajtja e armëve dhe municioneve) përveç instruktorëve dhe ndihmësinstruktorëve, duhet të jetë i pranishëm edhe trajnuesi për ndihmën e shpejtë.

#### Neni 9

Pas përfundimit të trajnimit praktik për përdorimin e armëve, personi juridik i autorizuar i lëshon aplikantit një certifikatë për leje për blerjen e armëve (në vijim referuar si: kandidati) (Dokumenti 2).

### IV. KRYERJA E TESTIMIT TË NJOHURIVE TEKNIKE MBI PËRDORIMIN E DUHUR TË ARMËVE DHE TË NJOHURIVE MBI RREGULLORET E ARMËVE, PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT

#### Neni 10

Pas përfundimit të trajnimit praktik për përdorimin e armëve, kandidati paraqet kërkesën për kryerjen e testimit të njohurive teknike mbi përdorimin e duhur të armëve dhe të njohurive mbi rregulloret e armëve, për marrjen e autorizimit (Shtojca 3).

Kërkesa e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni i paraqitet njësisë organizative të Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas vendbanimit të përhershëm ose të përkohshëm të aplikantit në Republikën e Maqedonisë.

#### Neni 11

Testimi i njohurive teknike mbi përdorimin e duhur të armëve dhe i njohurive mbi rregulloret e armëve, për marrjen e autorizimit (në vijim referuar si: testimi për marrjen e autorizimit) kryhet përpara një komisioni të përbërë nga kryetari, tre anëtarë, një sekretar dhe zëvendësit e tyre.

Kryetari, një nga anëtarët e Komisionit dhe Sekretari janë përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, anëtari i dytë i Komisionit është përfaqësues i Federatës Sportive të Qitjes së Maqedonisë dhe anëtari i tretë është përfaqësues i personit juridik të autorizuar që kryen trajnimin praktik për përdorimin e armëve.

#### Neni 12

Pas marrjes së kërkesës, Kryetari i Komisionit planifikon datat dhe orën e testimit për marrjen e autorizimit dhe i informon anëtarët e Komisionit dhe kandidatët që kanë aplikuar maksimumi dy muaj përpara testimit, por jo më vonë se tetë ditë përpara testimit të planifikuar.

#### Neni 13

Testimi përbëhet nga pjesa teorike dhe praktike e programit të trajnimit dhe kryhet në të paktën dy ditë.

Pjesa teorike e testimit për marrjen e autorizimit kryhet ditën e parë.

Pas kryerjes dhe marrjes së testimit të pjesës teorike, kandidatët e kryejnë pjesën praktike të testimit për marrjen e autorizimit ditën vijuese të punës.

#### Neni 14

Testimi kryhet të paktën dy herë në muaj, në ambientet e personit juridik të autorizuar për ofrimin e trajnimit praktik për përdorimin e armëve.

#### Neni 15

Kryerja e pjesës teorike të testimit për marrjen e autorizimit nënkupton rrethimin e përgjigjes së saktë nga tre alternativat për secilën nga 20 pyetjet e testit me shkrim.

Çdo përgjigje e saktë e pyetjeve, vlerësohet me pikë.

Pyetjet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni hartohen nga Komisioni pak përpara kryerjes së testimit të pjesës teorike për marrjen e autorizimit dhe janë të njëjta për të gjithë kandidatët që e kryejnë këtë pjesë të testimit në të njëjtën kohë.

#### Neni 16

Pjesa teorike e testimit zgjat 45 minuta dhe kryhet nga të gjithë kandidatët në të njëjtën kohë.

#### Neni 17

Pjesa praktike e testimit kryhet për të testuar njohuritë e kandidatit për:

- mbajtjen e armës në mënyrë të sigurt dhe në drejtimin e duhur;
- kontrollin nëse arma është e mbushur apo jo;
- funksionimin e të gjitha pjesëve të jashtme të armës;
- mbushjen dhe zbrazjen e armëve;
- çmontimin dhe montimin armëve;
- pastrimin dhe mirëmbajtjen e armëve dhe municioneve;
- zgjedhjen e municionit të duhur për armën;
- përgatitjen e armës dhe mbajtjen e saktë e saj;
- demonstrimin praktik të kalimit të pengesave gjatë përdorimit të armës;
- përdorimin e mjeteve mbrojtëse; dhe
- praktikën në qitje.

#### Neni 18

Qitje me armë zjarri me tytë të shkurtër në shënjestër të rrumbullakët, me përmasa 50 cm x 50 cm, në largësi prej 10 metrash nga vendi i qitjes.

Qitje me armë pneumatike në shënjestër të rrumbullakët, me përmasa 15,5 cm x 15,5 cm, në largësi prej 10 metrash nga vendi i qitjes.

Qitje me armë zjarri të gjata me tytë të vjaskuar në shënjestër të rrumbullakët me përmasa 100 cm x 100 cm, në largësi prej 100 metrash nga vendi i qitjes dhe qitje me armë zjarri të gjata me tytë të pavjaskuar në shënjestër të rrumbullakët me përmasa 100 cm x 100 cm, në largësi prej 35 metrash nga vendi i qitjes.

Në testin e qitjeve me armët e përmendura në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, brenda tre minutash kryhen tre qitje, ndërsa për vlerësimin e pjesës praktike të testimit për marrjen e autorizimit, kandidati kryen dhjetë qitje në dhjetë minuta.

Kandidati trajnohet që të gjuajë vetëm me llojin e armës për të cilën ai/ajo ka paraqitur kërkesën për lëshimin e lejes për blerjen e saj.

#### Neni 19

Përveç kandidatit dhe anëtarëve të komisionit, gjatë ushtrimit të qitjes janë të pranishëm edhe instruktorët, ndihmësinstruktorët dhe trajnuesi për ndihmën e shpejtë.

#### Neni 20

Arritja e kandidatit në testimin për marrjen e autorizimit vlerësohet si “ka kaluar testimin për marrjen e autorizimit” ose “nuk ka kaluar testimin për marrjen e autorizimit”.

Kandidati kalon pjesën teorike të testimit për marrjen e autorizimit nëse merr të paktën 75% të numrit total të pikëve në testimin me shkrim.

Kandidati kalon pjesën praktike të testimit për marrjen e autorizimit nëse ai/ajo e përdori armën me siguri dhe mori mbi 30% të numrit total të pikëve gjatë ushtrimit të qitjes.

#### Neni 21

Kandidati që nuk kalon pjesën teorike të testimit për marrjen e autorizimit mund të paraqesë një kërkesë për ripërsëritjen e testimit të pjesës teorike brenda jo më pak se 7 ditësh dhe jo më shumë se 14 ditësh nga data e kryerjes së testimit të mëparshëm.

Kandidati që nuk kalon pjesën praktike të testimit për marrjen e autorizimit mund të paraqesë një kërkesë për ripërsëritjen e testimit të pjesës praktike brenda jo më pak se tre ditësh nga data e kryerjes së pjesës praktike të testimit që nuk e kaloi.

Kandidati vlerësohet si kandidat që nuk e ka kaluar testimin nëse ai/ajo nuk aplikon për ripërsëritjen e tij brenda afateve të specifikuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni ose nëse ai/ajo nuk arrin rezultate të kënaqshme në ripërsëritjen e testimit.

Pjesët teorike dhe praktike të testimit për marrjen e autorizimit ripërsëriten përpara Komisionit të përmendur në nenin 11 të kësaj Rregulloreje.

#### Neni 22

Kandidatit që kalon testimin për marrjen e autorizimit i lëshohet një certifikatë nga Komisioni (Dokumenti 4).

#### Neni 23

Dokumentet 1 deri në 4 janë pjesë përbërëse të kësaj Rregulloreje.

### V. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

#### Neni 24

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë pas datës së botimit të saj në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

NR. 17.1-53577/1  
13 shtator 2005  
Shkup

Ministri  
i Punëve të Brendshme,  
**Ljubomir Mihajlovski**, (nënshkrimi)

**PROGRAMI I TRAJNIMIT**  
**për përdorimin, magazinimin dhe mirëmbajtjen e duhur të armëve**

**A. PJESA TEORIKE**

**I. Ligji “Për armët” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 7/2005) dhe aktet nënligjore në zbatim të ligjit “Për armët”;**

- I/1. Dispozita të përgjithshme;
- I/2. Blerja dhe posedimi i armëve dhe municioneve;
- I/3. Mënyra e përdorimit të armëve dhe municioneve;
- I/4. Prodhimi dhe riparimi i armëve dhe municioneve;
- I/5. Tregtia e armëve, municioneve dhe pjesëve të armëve;
- I/6. Transportimi i armëve dhe municioneve;
- I/7. Poligonet civile të qitjes;
- I/8. Transferimi i armëve dhe municioneve përmes kufirit shtetëror;
- I/9. Shtetas të shtetit anëtar të Bashkimit Evropian;
- I/10. Regjistrat;
- I/11. Mbikëqyrja; dhe
- I/12. Aktet nënligjore në zbatim të ligjit “Për armët”.

**II. Kodi Penal (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 37/96, 80/99, 4/02, 43/03 dhe 19/04)**

- II/1. Krimi dhe përgjegjësia penale; dhe
- II/2. Prodhimi, posedimi dhe trafikimi i paligjshëm i armëve dhe municioneve shpërthyes.

**III. Ndhimja e shpejtë**

- III/1. Çfarë është ndihma e shpejtë?
- III/2. Mjetet për dhënien e ndihmës së shpejtë;
- III/3. Detyrimi për dhënien e ndihmës së shpejtë;
- III/4. Dhënia e ndihmës së shpejtë për personin e lënduar në vendin e aksidentit;
- III/5. Kontrolli për shenja jete;
- III/6. Gjakderdhja;
- III/7. Llojet e lëndimeve; dhe
- III/8. Kujdesi dhe transportimi i të lënduarit.

**IV. Njohuritë teorike mbi përdorimin e sigurt të armëve dhe municioneve (çmontimi, montimi, pastrimi dhe mirëmbajtja e armëve dhe municioneve).**

- IV/1. Çmontimi, montimi, pastrimin dhe mirëmbajtja e armëve dhe municioneve;
- IV/2. Karakteristikat teknike të disa armëve të caktuara;
- IV/3. Përdorimi i sigurt i armëve; dhe
- IV/4. Aplikimi i masave mbrojtëse gjatë qitjes.

**B. PJESA PRAKTIKE**

**Njohuri praktike mbi përdorimin e sigurt të armëve dhe municioneve (çmontimi, montimi, pastrimi dhe mirëmbajtja e armëve dhe municioneve)**

- I/1. Mbajtja e armës në mënyrë të sigurt dhe në drejtimin e duhur;
- I/2. Kontrolli nëse arma është e mbushur apo jo;
- I/3. Funkcionimi i të gjitha pjesëve të jashtme të armës;
- I/4. Mbushja dhe zbrazja e armës;
- I/5. Çmontimi dhe montimi i armëve;
- I/6. Pastrimi dhe mirëmbajtja e armëve dhe municioneve;
- I/7. Zgjedhja e municionit të duhur për armën;

I/8. Përgatitja e armës dhe mbajtja e saktë e saj;

I/9. Demonstrimi praktik i kalimit të pengesave gjatë përdorimit të armës; dhe

I/10. Përdorimi i mjeteve për mbrojtje; dhe

## **II. Qitje me armë.**

II/1. Kryerja e testimit të qitjes me armë zjarri të shkurtra dhe të gjata, si edhe me armë pneumatike, me tre plumba brenda tre minutave në shënjestër të rrumbullakët në largësi prej 10, 35 dhe 100 metrash, në varësi të llojit të armës;

II/2 Qitje me armë zjarri me tytë të shkurtër në shënjestër të rrumbullakët me përmasa 50 cm x 50 cm, në largësi prej 10 metrash nga vendi i qitjes;

II/3. Qitje me armë pneumatike në shënjestër të rrumbullakët, me përmasa 15,5 cm x 15,5 cm, në largësi prej 10 metrash nga vendi i qitjes.

II/4. Qitje me armë zjarri të gjata me tytë të vjaskuar në shënjestër të rrumbullakët me përmasa 100 cm x 100 cm, në largësi prej 100 metrash nga vendi i qitjes dhe qitje me armë zjarri të gjata me tytë të pavjaskuar në shënjestër të rrumbullakët me përmasa 100 cm x 100 cm, në largësi prej 35 metrash nga vendi i qitjes.

Republika e Maqedonisë

\_\_\_\_\_  
(emri i personit juridik të autorizuar, shoqata e gjuetarëve ose e qitësve)

Në përputhje me nenin 14, paragrafët 5 dhe 6 të ligjit “Për armët” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 7/2005) dhe me nenin 9 të Rregullores për programin e trajnimit për përdorimin, magazinimin, mirëmbajtjen e duhur të armëve, për kryerjen e trajnimit praktik për përdorimin e armëve, si dhe për kryerjen e testimit të njohurive teknike mbi përdorimin e duhur të armëve dhe të njohurive mbi rregulloret e armëve, për marrjen e autorizimit (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. \_\_/\_\_),

\_\_\_\_\_, lëshon këtë  
(personi juridik i autorizuar, shoqata e gjuetarëve ose e qitësve)

CERTIFIKATË

\_\_\_\_\_ lindur më \_\_\_\_\_ në  
(emri dhe mbiemri)  
\_\_\_\_\_, me numër unik regjistrimi të  
shtetasit \_\_\_\_\_,  
(vendi i banimit)

ka kaluar trajnimin praktik për përdorimin e armëve.

Trajnuesit-Instruktorët

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_

(vula)

**KËRKESË**  
**PËR KRYERJEN E TESTIMIT TË NJOHURIVE TEKNIKE MBI PËRDORIMIN E**  
**DUHUR TË ARMËVE DHE TË NJOHURIVE MBI RREGULLORET E ARMËVE**  
**PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT**

TË DHËNA PËR APLIKANTIN (KANDIDATI)

Emri, atësia dhe mbiemri \_\_\_\_\_  
 Data e lindjes \_\_\_\_\_  
 Vendi dhe shteti i lindjes \_\_\_\_\_  
 Vendi i banimit \_\_\_\_\_ rruga \_\_\_\_\_ numër \_\_\_\_\_  
 Telefon \_\_\_\_\_  
 Numri unik i regjistrimit i shtetasit \_\_\_\_\_

Me anë të këtij dokumenti aplikoj për kryerjen e testimit të njohurive teknike mbi përdorimin e duhur të armëve dhe të njohurive mbi rregulloret e armëve që përfshin lëndët e mëposhtme:

Nr.	Lënda	Testimi i parë	Ripërsëritja e testimit
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			
6.			

Gjenibashkëngjitur dokumentin që vërteton pagesën e tarifës së testimit për marrjen e autorizimit në shumën prej dinarë

Identiteti i kandidatit është përcaktuar nga Kryetari i Komisionit në bazë të ID-së ose pasaportës pak përpara fillimit të testimit për marrjen e autorizimit.

Në \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_

NËNSHKRIMI I APLIKANTIT

\_\_\_\_\_





**REPUBLIKA E MAQEDONISË**  
**MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME**

Numri \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Në përputhje me nenin 22 të Rregullores për programin e trajnimit për përdorimin, magazinimin dhe mirëmbajtjen e duhur të armëve, për kryerjen e trajnimit praktik për përdorimin e armëve, si dhe për kryerjen e testimit të njohurive teknike mbi përdorimin e duhur të armëve dhe të njohurive mbi rregulloret e armëve për marrjen e autorizimit ("Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. \_\_/\_\_), Komisioni i formuar nga Ministri i Punëve të Brendshme lëshon këtë

**CERTIFIKATË**

\_\_\_\_\_ lindur më \_\_\_\_\_  
(emri, atësia dhe mbiemri) (data, vendi dhe shteti i lindjes)  
nga \_\_\_\_\_ rruga \_\_\_\_\_ numër \_\_\_\_\_  
(vendi i banimit)  
me numër unik regjistrimi të shtetasit \_\_\_\_\_.

në \_\_\_\_\_ ka kryer testimin e njohurive teknike mbi përdorimin, magazinimin dhe mirëmbajtjen e duhur të armëve dhe të njohurive mbi rregulloret e armëve, për marrjen e autorizimit dhe

**KA KALUAR TESTIMIN E NJOHURIVE TEKNIKE MBI PËRDORIMIN E DUHUR TË ARMËVE DHE TË NJOHURIVE MBI RREGULLORET E ARMËVE PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT**

(vula)

**KRYETARI I KOMISIONIT**

\_\_\_\_\_